

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

**RELACIONI I MASËS YNDYRORE NË RAPORT ME
AFTËSITË FUNKSIONALE AEROBE TE FUTBOLLISTËT**

MENTORI:
DR.SC. Bylbyl Sokoli

KANDIDATI:
Ismet Caka

Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. PROBLEMI, LËMIA, QËLLIMI DHE DETYRAT	7
3. HIPOTEZAT THEMELORE	8
4. METODOAT E PUNËS	9
4.1. MOSTRA E ENTITETIT	10
4.1. MOSTRA E VARIABLAVE	10
4.1.1. Variablat antropometrike.....	10
4.1.2. Variabla e aftësive funksionale	10
4.2. TEKNIKA E MATJEVE TË VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE	11
4.3. METODAT E PËRPINIMIT TË REZULTATEVE	18
5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE	19
5.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE FUNKSIONALE	19
5.2. ANALIZA E VARIANSES.....	52
5.3. REZULTATET E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET VARIJABLAVE ANTROPOMETRIKEDHE FUNKSIONALE	61
5.4. ANALIZA REGRESIVE E NDRYSHOREVE TË PAVARURA DHE NDRYSHORËS SË VARUR TE FUTBOLLISTËT.....	64
5.5. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE	66
6. PËRFUNDIMI	67
7. LITERATURA	69
REZYME	71
SUMMARY	72

1. HYRJE

Karakteristikat optimale morfologjike të sportistëve kryesisht varen nga lloji i sportit. Në përgjithësi rezultate më të mira arrijnë ata të cilët ndërtimi trupor i përshtatet kërkesave specifike të sportit konkret. Suksesit në sport gjithsesi varet edhe nga karakteristikat morfologjike të sportistëve, nga të cilat lartësia dhe pesha e trupit janë themelore, e të cilat valorizohen duke marr parasysh moshën aktuale të sportistit. Të dhënat e lartë përmendura duhet shumë shumë respektuar gjatë rritjes dhe zhvillimit të sportistëve, kur mosha kronologjike dhe biologjike shpesh nuk janë të koordinuara, dhe ajo është zakonisht një periudhë kur profilizohen sportistët kulmor të ardhshëm (Malina et al, 2004; Mišigoj-Durakovic, 2008).

Definimi i konstitucionit të njeriut e sidomos i sportistit është shumë kompleks për shkak të disa faktorëve të cilët në mënyrë direkte ndikojnë në veçoritë morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të tij. Vet reaktioni i organizmit si tërësi në disa ngacmime respektivisht sjellje në situata të ndryshme të jetes dhe punës përbëjnë grupin e të gjitha veçorive morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të cilët japin karakter konstitucionit të njeriut respektivisht paraqet fenotipin i cili zhvillohet si simbioza e gjenotipit të caktuar i cili është nën ndikimin e faktorëve kompleks të jashtëm.

Shumë autorë dukur apo nocionin e gjenotipit shpesh e kanë identifikuar me konstitucionin trupor. Mirëpo nocioni i konstitucionit është shumë më i gjerë dhe plastik dhe vet mundësia e formimit në kushte të rrethit në të cilën njeriu jeton, nën veprimin e mënyrës së të jetuarit, punës dhe edukimit na orjenton neve që të kuptojmë se në konstitucionin e njeriut ndikim fundamental kanë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të zhvillimit të njeriut.

Kur bëhet fjalë për konstitucionet nuk mundemi që ndarasi të flasemi për tipet e meshkujve dhe të femrave sepse tipet konstitucionale janë të pavarur nga gjinia, dhe se të gjitha llojet e tipeve i hasim te dy gjinit. Gjithashtu nuk ekziston ndaras ose veç konstitucioni e disa moshave sepse fëmija shumë shpejt në zhvillimin e vet ndryshom dhe më von pas vitit të 10 kemi diferencimin e parë e disa tipeve ashtu që tipin konstitucional definitiv të i rrituri do të formohet pas vitit të 20. Tek njerzit e moshuar tipet konstitucionale ndryshojnë në rend të parë në drejtim komponentes funksionale. Klasifikimin e disa tipeve konstitucionale mund ta shikojmë me metodën subjektive ku dominon vëzhgimi dhe vlerësimi i disa veçoriv, e netoda tjetër është objektive ku dominon matja e disa veçorive dhe krahasimi i tyre. Më së miri është të shfrytëzohen dy metodat.

Nëse për shembull, e marrim që ta vëzhgojmë konstitucionin trupor vetëm sipas kriteriumeve morfologjike, vijmë në përfundim që ky klasifikim ka dy tipe shumë të kundërt të shprehur, ku në njëren anë mbretrojnë lartësia (parametrat e gjatësisë) dhe të tjerët gjerësia e trupit (transversale). Ekziston edhe tipi mesatar tek i cili nuk ka dominim të asnjëres nga veçoritë morfologjike të dhëna.

Antropometrija (somatometrija) është metodë e matjes e trupit të njeriut, respektivisht të disa pjesëve të trupit, me të cilën në mënyrë kuantitative përcaktohen veçoritë morfologjike dhe shikohet pasqyra objektive e gjendjes dhe zhvillimit të njeriut.

Antropologjia morfologjike është metodë e cila përfshinë matjet e trupit të njeriut, përpunimin dhe studimin e matjeve të fituara. Në sporte të ndryshme si ato amatore ashtu edhe kulminante kjo shërben për:

- Selektionimin e kandidatve për çdo sport
- Përcjelljen dhe evaulimin e procesit stërvitor
- Vlerësimin objektiv e zhvillimit të përgjithshëm të trupit
- Kontrollimit të gjendjes së ushqyeshmërisë së sportistit
- Përcjelljen e çlodhjes së sportistit në procesin e rehabilitimit

Rëndësia e ndërtimit të trupit për sportet kulminante nuk është e definuar në tërësi si parakusht për arritjen e rezultateve kulmore në sportet kulminante. Prap se prap, hulumtimet kanë treguar se sportistët e suksesshëm tregojnë ngjajshmëri në ndërtimin dhe në raportin e masës yndyrore dhe jo yndyrore trupore, dhe këto shprehen më shumë duke përparuar dmth. duke arritur kategori gjithë e më të larta në sportin kulmor. Sipas kësaj, sportistët kulminant, shikuar në aspektin morfologjik janë grupë relativisht homogjene, varësisht nga sporti, është i mundur të definohet modeli i cili dëshirohet të arrihet ashtu që të arrihen rezultate kulminante.

Njohja e strukturës së disa dimensioneve të statusit psikosomatik të sportistit, me këtë edhe zhvillimit të tij, paraqet kushtin themelor për udhëheqje të suksesshme të procesit stërvitor. Duke iu falënderuar numrit të madh të hulumtimeve të cilat janë marrur me përcaktimin e strukturës të disa pjesëve të hapësirës antropometrike, në shkallën e sotme të zhvillimit të shkencës në kulture fizike, me siguri të madhe mund të flasim mbi ekzistimin veçorive të ndryshme.

Me karakteristika morfologjike të strukturës të statusit psikosomatik të njeriut nënkuptojmë sistem të caktuar të dimensioneve latente antropometrike pa marr parasysh atë se, a janë zhvilluar këto dimensioneve në ndikimin e vaçant të rrethit të jashtëm (me trajning të caktuar) apo

jo. Në pajtim me këte, që të vërtetohen në mënyrë shkencore dimensionet latente të kësaj hapsire, zgjidhja është mbështetur në aplikimin e analizës faktoriale dhe analizës regressive. Kështu janë izoluar faktorët antropometrik të cilat janë definuar si dimensione latente (nga seria e variablave manifeste), dhe të cilat janë përgjegjëse për kovariabilitetin e gjendjeve të ndryshme manifeste dhe reaksioneve në atë hapësirë. Para se gjithash, analiza faktoriale mundëson të hyjmë në esencë të strukturës morfologjike dhe dimensioneve të tjera të statusit psikosomatik të njeriut duke zbuluar dimensione latente, të cilat janë përgjegjëse për manifestimet e jashtme të dukurive konkrete.

Aftësia funksionale është e kushtëzuar me raportin ndërmjet aftësive të lindura (trashëguese) dhe të fituara për përshtatje. Aftësia për adaptim është veçori e cila manifestohet si poçes biologjik vetëm pas ndikimit e cila kryhet në homeostazën dinamike të organizmit dhe rezulton me përgjigjeje aktive specifike të organizmit në këto ndikime⁴. Në hapësirën e karakteristikave antropologjike në lëmin e kineziologjis vende të rëndësishëm zen hulumtimet që kanë të bëjnë me njohjen e aftësive funksionale të organeve të brendshme si dhe atyre motorike. Autor të shumtë kanë vërtetuar se aftësia e muskujve për tu kontrahuar shpejt ndërpritet nëse pengohet sjellja e materieve energjetike në muskuj. Këtu shihet rëndësia e aftësive funksionale gjatë ekzekutimit të lëvizjeve të ndryshme. Në hapësirën e aftësive funksionale të njeriut ende nuk ekziston ndonjë model teorik mbi strukturën latente të këtyre aftësive. Hulumtimet e gjertanishme kanë qenë të orientuara në studimin e funksionimit të disa organeve dhe sistemit të organeve ku gjer më tani janë përcaktuar një numër ligjesh mbi ndërtimin dhe funksionimin e organizmit. Funksionimi i organizmit ndryshon në situata të ndryshme, por më së shpeshti dhe më së tepërmi tek aktivitetet fizike. Për këtë është e nevojshme që sistemi kardiovaskular pandërprerë ti përshtatet nevojave të organizmit ashtu që nevoja dhe oferta me gjak në tërë organizmin dhe në organe të jetë gjithmonë në harmoni. Sistemi kardiovaskular i përshtatet nevojave të organizmit: 1. Duke e rritur sasinë e gjakut , të cilën zemra e hedhe në njësi të kohës, 2. Duke e orientuar gjakun më tepër në organe aktive. Në procesin e përshtatjes veprojnë zemra si pompë, arteriet dhe vanat, të cilat ndryshojnë volumenin e tyre e më këtë rezistencën dhe shpërndarjen e gjakut në organizëm , kapilarët, të cilët me hapjen e tyre në organet aktive rrisin sipërfaqen e ndërrimit të materieve ndërmjet gjakut dhe indeve.

Treguesi kryesor i gjndjes përgatitore të sistemit për transportin e oksigjenit (kardiovaskular dhe respirator) është pranimi i oksigjenit (VO₂). Vlerat relative të pranimit të oksigjenit futbollistëve

të ligës së parë gjermane sillen prej 60-67 ml / min / kg (Verheijen, 1998)., Me një normë maksimale të zemrës që arrin një vlerë prej 185-195 të rrahura në minut. (Weineck, 2000).

Punimet që kanë të bëjnë me lidhshmërinë ndërmjet karakteristikave antropologjike te futbollistët janë të shumta. Në këtë fushë, punimet më të pakta janë ato që kanë të bëjnë me lidhshmërinë e aftësive funksionale dhe aftësive motorike te futbollistët. Shkaku nuk qëndron në pamjaftueshmërinë ose në definimin jo adekuat të hapësirës motorike sa në mungesën e ndonjë modeli teorik mbi strukturën latente të aftësive funksionale. Për këtë arsye punimet më të shpeshta janë ato të cilat kanë të bëjnë me ndikimin e disa aftësive funksionale në efikasitetin motorik gjatë ekzekutimit të disa aktiviteteve tipike kineziologjike, si dhe në transformimin e aftësive funksionale nën ndikimin e stimuluesve të ndryshëm kineziologjik. Disa autor kanë tentuar të përcaktojnë lidhshmërinë në mesë të aftësive motorike dhe funksionale. Në këtë drejtim vlen të përmendet hulumtimi i cili si teste motorike ka përdorur vrapimet në distanca të ndryshme, dhe për aftësitë funksionale është përdorur testi i pranimit maksimal të oksigjenit. Mirëpo, të gjitha këto punime nuk kanë qenë në masë të mjaftueshme të valorizuar, kështu që komparacioni me punime tjera, aplikimi praktik dhe gjeneralisimi i rezultateve është shumë i kufizuar ose gati i pamundshëm.

2. PROBLEMI, LËMIA, QËLLIMI DHE DETYRAT

Njohurit mbi zhvillimin morfologjik dhe funksional te lojtarët e lojës së futbollit duhet të paraqesin një ndër preokupimet kryesore të trajnerëve dhe stafit drejtues të ekipeve. Nga një pasqyrë e till varet edhe niveli shëndetësor, social dhe sportiv i një shoqërie.

Problemi i këtij hulumtimi paraqet analizimin i disa parametrave morfologjik e funksional të sportistëve të lojës së futbollit. Problemi i cili trajtohet në këtë punim është i një rëndësie të veçantë, sepse nga rezultatet e fituara mund të vlerësojmë dhe të jepet një pasqyrë reale të zhvillimit fizik dhe funksional të kësaj popullate si dhe të japim një pasqyrë sa më reale të ndikimit të faktorëve të ndryshëm morfologjik në ata funksional dhe në përcaktimin e masës aktive (jo yndyrore) dhe pranimin e oksigjenit si dhe Indeks të Masës Trupore te sportistët e lojës së futbollit.

Lëmia e hulumtimit paraqet karakteristikat morfologjike dhe aftësitë funksionale si dhe masen aktive dhe Indeksi i Masës Trupore te futbollistët të lojës së futbollit si dhe të rëndësisë së ndikimit të faktorëve të ndryshëm morfologjik në ata funksional.

Qëllimi i këtij punimi është të përcaktohet raporti i zhvillimit fizik, i masës aktive trupore, indeksi i masës trupore, pranimit maksimal të oksigjenit me anë të testit motorik të qëndrueshmërisë si dhe të vërtetohet ndikimi faktorëve të ndryshëm morfologjik në ata funksional te futbollistët e Superligës së Kosovës në futboll.

Detyrat – Për realizimin e qëllimit të parashtruar, janë parashtruar këto detyra të hulumtimit:

- Të përcaktohet niveli i zhvillimit morfologjik,
- Të përcaktohet niveli i Indeksit të Masës Trupore (IMT),
- Të përcaktohet niveli i masës aktive,
- Të përcaktohet niveli i masës pasive,
- Të përcaktohet niveli i pranimit të oksigjenit (O₂).

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë dhe problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrohen këto hipoteza:

H₀₁ – Distribucioni i fituar i variablave antropometrike dhe funksionale të aplikuara në këtë punim nuk do të kenë asimetri të theksuar.

H₀₂ – Rezultatet e variablave antropometrike dhe funksionale kanë koeficiente të korrelacionit statistikisht të rëndësishme.

H₀₃ Indeksit të Masës Trupore te sportistët e lojës së futbollit do të jetë në kufinjt e vlerave normale.

H₀₄ – Ndryshimet në vlerat antropometrike dhe funksionale, në parametrat e masës yndyrore dhe asaj jo yndyrore në mes sportistëve të klubeve të futbollit, do të jenë statistikisht të rëndësishme.

H₀₅ Ndikimi faktorëve të ndryshëm morfologjik në ate funksional do të jetë statistikisht i rëndësishëm.

4. METODOAT E PUNËS

Cili do problem antropologjike është e mundur të operacionalizohet në shumë mënyra të ndryshme. Megjithatë, natyra e shumicës së problemeve dhe karakteristikave të proceseve shpesh kërkojnë një qasje multivariante.

Duke marrë këtë parasysh, është e nevojshme të kuptojmë dhe të përdorim disa metoda matematikore dhe statistikore në këtë studim, ku do të përzgjidhen ata për të cilat supozohet se do të ndihmojnë në nxjerrjen e konkluzioneve rreth natyrës së problemit të parashtruar.

Në lidhje me njohjen e problemit, ky studim paraqet hulumtim konfirmativ ku në bazë të një problemi të njohur kryhet kontrolli i hipotezave të parashtruara duke përdorur metoda të përshtatshme dhe drafte kërkimore.

Në kushtet e përcaktimit kohor, studimi është i karakterit transfersal, dhe konsiston në një matje të vetme të treguesve përkatës të karakteristikave morfologjike, të cilët janë aktiv në sporte përkatëse.

Në lidhje me shkallën e kontrollit, ky hulumtim shkencor i përket ose bien në kategorinë e hulumtimit shkencore në teren që do të kryhet ose realizohet në kushte natyrore të jetës (Bala,2007b).

4.1. MOSTRA E ENTITETIT

Popullata nga e cila do të merret mostra për hulumtim për këtë punim është definuar si popullatë e lojtarëve aktiv të Superligës në Futboll gjatë vitit kalendarik 2013/14. Ekipet të cilat janë përfshirë në hulumtim janë: Ekipet e Superligës së Kosovës në futboll. Në këtë hulumtim janë përfshirë 11 ekipe të Raiffeisen Superligës së Kosovës, me gjithsej 220 lojtarë. KF “Prishtina”, KF “Llambasari”, KF “Drenica”, KF “Besa”, KF “Drita”, KF “Trepça”, KF “Feronikli”, KF “Ajvalia”, KF “Fushë Kosova”, KF “Trepça 89” dhe KF “Ferizaj”

Matjet antropometrike janë kryer në orët e paraditës, e ato funksionale janë kryer në mënyrë individuale dhe rezultatet e fituara janë marr nga lojtarët.

4.1. MOSTRA E VARIABLAVE

Në këtë punim janë aplikuar tri variabla antropometrike, një parametër i masës yndyrore dhe një parametër i masës jo yndyrore si dhe Indeksi i Masës Trupore.

4.1.1. Variablat antropometrike

Janë aplikuar këto variabla antropometrike:

ALARTE – Lartësia e trupit

APESHA – Peshë e trupit

AIDHBA – Indi dhjamor nën lëkuror i barkut

BMI – Indeksi i Masës Trupore

MATAKT – Masa trupore aktive (jo yndyrore)

MATPAS – Masa trupore pasive (yndyrore)

4.1.2. Variabla e aftësive funksionale

Është aplikuar vetëm një test për matjen e aftësive funksionale – pranimin maksimal të oksigjenit:

VO2MAX – Testi i Kuperit

4. 2. TEKNIKA E MATJEVE TË VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE

Variablat antropometrike janë matur sipas mënyrës siç vijon:

1. Lartësia e trupit – ALARTE është matë me antropometër sipas Martinit. Gjatë matjes i testuari është i zbathur në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim në bazën e rrafshët të antropometrit. Koka e të testuarit duhet të jetë në aso pozite që drejtëza e Frankfurtit të jetë horizontale. I testuari drejton shpinën aq sa është e mundur, dhe shputat i ka të bashkuara. Testuesi qëndron nga ana e majtë dhe kontrollon se akrepi i antropometrit a është vendosur vertikalisht në mënyrë të drejtë drejtpërdrejt përgjatë pjesës së mbrapse të trupit të testuarit dhe pastaj, lëshon unazën metali

Foto 1. Matja e lartësisë trupit (ALARTË)




2. Pesha e trupit – APESHA është matë me peshore transportabile të vendosur në sipërfaqe të rrafshët. I testuari, zbathur dhe në brekë vendoset në mesin e peshores dhe qëndron në drejtqëndrim. Atëherë kur akrepi në peshore nuk lëvizë, rezultati lexohet me saktësi prej 0,5 kg.

Foto 2. Matja e peshës së trupit (APESHA)



3. Indi dhjamor nënlëkuror i barkut – AIDHBA është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahve të kaliperit në lëkur të jet $10\text{gr}/\text{mm}^2$. Para matjes i testuari është i zbathur, në brek dhe qëndron në drejtëqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë dhe relaksim të muskujve të barkut. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën në anën e majtë të barkut në nivel të kërthizës (ombilikusit) dhe 5 cm në të majtë nga ai, duke patur kujdes që të mos kap edhe inde muskulore , kap palën (rrudhën) me majet e akrepave të kaliperit(të vendosur medialisht nga majet e gishtrinjëve). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 3. Indi dhjamor nënlëkuror i barkut (AIDHBA)



4. AMJOYN – Masa jo yndyore (aktive) trupore është fituar në bazë të formulës e cila është dhënë më poshtë*. Numri 10.260 mblidhet me numrin i cili fitohet nga shumzimi i numrit 0.7929 dhe peshës së trupit (PT) e që nga ky numër zbritet numri i fituar 0.3676 i cili shumëzohet me vlerën e indit dhjamor të barkut (AIDHBA).

Për meshkuj

$$\text{LBM} = 10.260 + 0.7927 \times (\text{APESHA}) - 0.3676 \times \text{AIDHB}$$

* Willmorit me bashkëpunëtor (1969).

5. AMYNDY – Masa jo aktive (yndyrore) trupore (pasive) është fituar në bazë të formulës e cila është dhënë më poshtë*. Numri 10.260 mblidhet me numrin i cili fitohet nga shumzimi i numrit 0.7929 dhe peshës së trupit (PT) e që nga ky numër zbritet numri i fituar 0.3676 i cili shumëzohet me vlerën e indit dhjamor të barkut (AIDHBA) dhe është zbritur nga pesha trupore.

Për meshkuj

$$\text{LBM} = (\text{PESHA}) - (10.260 + 0.7927 \times (\text{APESHA}) - 0.3676 \times \text{AIDHB})$$

* Willmorit me bashkëpunëtor (1969).

6. BMI – Indeksi i Masës Trupore $IMT = m/v^2$ ose $IMT = kg/v^2$

Në pyetje është matja e yndyrës trupore, duke shfrytëzuar lartësinë dhe peshën e trupit. Ashtu që pesha e trupit pjestohet me lartësinë e trupit e shprehur në metra dhe e shumëzuar me vetveten. Nëse një sportistë është peshon 70 kg dhe është i lartë 170 cm atëherë $170 = 1.70$ dhe kjo shumëzohet me vetveten ose ngritet në katror. $IMT = 70/1.70^2 = 70/2.89$; **IMT = 24.22**

BMI – Indeksi i masës trupore (IMT) (body mass index - BMI) tregon në atë se cilën pjesë të peshës së trupit e përbën undyra. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) Indeks të masës trupore e ka preferuar si më adekuat për vlerësimin e dhjamërisë. Në pyetje është matja e dhjamt trupor, duke e shfrytëzuar lartësinë dhe peshën dhe atë ashtu që lartësia pjestohet me peshën dhe indeksi i fituar shpreh shkallën e dhjamosjes. Indeks i masës trupore (BMI) = $kg/m^2 = m/v^2$. Paushqyeshmëri < 18,5; Peshë normale 18,5-24,9; Peshë e lartë 25-29,9; dhe e dhjamosur 30 e më tepër.

Variabla e aftësive funksionale është matur sipas mënyrës siç vijon:

7. FIZKUP – Testi i Kuperit

E gjitha që është e nevojshme për këtë test të thjeshtë është një kronometër dhe mundësisht shtegu i atletikes për matjen sa më të lehtë të distancës së vrapuar.

Testi përfshin matjen e distancës të cilën e testuara arrin ta vrapoj për një periudhë prej 12 minutash. Matësi i kohës është përgjegjës për regjistrimin e saktë të distancës apo shtegut të vrapuar.

Formula për vlerësimin e VO₂max (ml/kg/min) me anë të testit të Kuperit (Sudarov, 2007) është:

$$\text{VO}_2\text{max ml/kg/min} = (\text{Shtegu i vrapuar (m)} - 504.9) / 44.73$$

$$\text{VO}_2 \text{ max} = (d-505)/45$$

Shtegu i vrapuar d (në metra)	Hargjimi i oksigjenit (ml/kg/min)
Më pak se 1600	Më pak se 25,0
1600 - 1999	25,0 do 33,7
2000 - 2399	33,8 do 42,5
2400 - 2799	42,6 do 51,5
2800 e më tepër	51,6 e më tepër

4.3. METODAT E PËRPINIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë që kërkimi shkencor që të jep zgjidhje të kënaqshme, është e nevojshme që të përdoren procedurat e duhura, të drejta dhe komparative e që janë të natyrës së atij problemi të dhënë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi janë zgjedhë procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo variabël antropometrike, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)

2. Lakorja e distribucionit ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë („skjunis”), dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës ("kurtozis").

3. Analiza e varianses - Për këte qëllim të hulumtimit do të na shërbej koeficienti i dallimit i **Takijevit**.

4. **Raportet e ndërlidhjeve** ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

5. **Analiza regressive** me anë të së cilës vërtetohet ndikimi faktorëve të ndryshëm morfologjik në ata funksional

5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE

5.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE FUNKSIONALE

Në tabelën 1 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe funksionale te futbollistët e KF “Prishtina”. Mostra ka përfshirë grupin 20 futbollist të të moshës mbi 19 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike lartësia e trupit (ALARTË) (Tabela 1) është 181.09cm. Rezultati minimal (172.20cm) dhe ai maksimal (190.30cm) i ndryshorës antropometrike lartësia e trupit tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një asim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtike). Futbollistët e KF “Prishtina në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 3.03$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik .

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike pesha e trupit (APESHA) është 75.27kg. Rezultati minimal (66.00kg) dhe ai maksimal (83.00kg) i ndryshorës antropometrike pesha e trupit tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një asim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtike). Futbollistët e KF “Prishtina në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 6.21$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike indi dhjamor nënlëkuror i barkut (AIDHNB) është 9.12mm. Rezultati minimal (5.00mm) dhe ai maksimal (20.00mm) i ndryshorës antropometrike indi dhjamor nënlëkuror i barkut tregon se egziston një dallim i theksuar në mes

futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Prishtina në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike nuk paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 45.75$). Ekzistimi i dallimeve të theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është platokurtike

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës indeksi i masës trupore (BMI) është 22.95. Rezultati minimal (20.66) dhe ai maksimal (24.61) i ndryshorës të indeksit të masës trupore tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtike). Futbollistët e KF “Prishtina në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 4.98$). Edhe pse egziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës masa aktive trupore (MATAKT) është 66.57kg. Rezultati minimal (60.01kg) dhe ai maksimal (73.41kg) i ndryshorës të masës aktive trupore tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtike). Futbollistët e KF “Prishtina në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 4.70$). Edhe pse egziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës masa pasive trupore (MATPAS) është 8.69kg. Rezultati minimal (5.75kg) dhe ai maksimal (13.68kg) i ndryshorës të masës pasive trupore tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Prishtina në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike nuk paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 25.57$).

Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës pranimi maksimal i oksigjenit (VO2MAX) është 49.47 ml/kg/min. Rezultati minimal (42 ml/kg/min) dhe ai maksimal (57 ml/kg/min) i ndryshorës të pranimi maksimal i oksigjenit tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Prishtina në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 8.64$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe funksionale te futbollistët e KF “Prishtina”

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis	KV
ALARTË	20	1722.00	1903.00	1810.9500	55.00285	-.003	-1.124	3.037237
APESHA	20	66.00	83.00	75.2750	4.68142	-.342	-.503	6.21909
AIDHNB	20	5.00	20.00	9.1200	4.17330	1.342	1.199	45.75987
BMI	20	20.66	24.61	22.9577	1.14465	-.447	-.665	4.985909
MATAKT	20	60.01	73.41	66.5780	3.13233	-.209	.366	4.704752
MATPAS	20	5.75	13.68	8.6970	2.22401	.840	.168	25.57215
VO2MAX	20	42.00	57.00	49.4750	4.27599	.105	-.701	8.642729

Në tabelën 2 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe funksionale te futbollistët e KF “Llamkos Kosova”. Mostra ka përfshirë grupin 20 futbollist të të moshës mbi 19 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike lartësia e trupit (ALARTË) (Tabela 2) është 180.57cm. Rezultati minimal (172.70cm) dhe ai maksimal (189.00cm) i ndryshorës antropometrike lartësia e trupit tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një asim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitive (epikurtike). Futbollistët e KF “Llamkos Kosova”. në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 2.62$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik .

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike pesha e trupit (APESHA) është 75.05kg. Rezultati minimal (64.00kg) dhe ai maksimal (95.00kg) i ndryshorës antropometrike pesha e trupit tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një asim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të lartë, sepse testi i asimetrisë është pozitive (epikurtike). Futbollistët e KF “Llamkos Kosova”. në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 10.16$). Ekzistimi i dallimimeve të theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është platokurtike

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike indi dhjamor nënlëkuror i barkut (AIDHNB) është 10.54mm. Rezultati minimal (6.20mm) dhe ai maksimal (19.80mm) i ndryshorës antropometrike indi dhjamor nënlëkuror i barkut tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një asim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF

“Llamkos Kosova” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike nuk paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 41.66$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës indeksi i masës trupore (BMI) është 23.00. Rezultati minimal (19.87) dhe ai maksimal (28.03) i ndryshorës të indeksit të masës trupore tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Llamkos Kosova” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 8.42$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës masa aktive trupore (MATAKT) është 65.8776kg. Rezultati minimal (58.35kg) dhe ai maksimal (78.66kg) i ndryshorës të masës aktive trupore tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Llamkos Kosova” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 7.78$). Ekzistimi i dallimimeve të theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është platokurtike.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës masa pasive trupore (MATPAS) është 9.17kg. Rezultati minimal (5.65kg) dhe ai maksimal (16.34kg) i ndryshorës të masës pasive trupore tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Llamkos Kosova” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike nuk paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 31.57$). Ekzistimi i dallimimeve të theksuara në mes rezultatit minimal dhe

atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është platokurtike

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës pranimit maksimal të oksigjenit (VO2MAX) është 50.94 ml/kg/min. Rezultati minimal (42.40 ml/kg/min) dhe ai maksimal (61.00 ml/kg/min) i ndryshorës të pranimit maksimal të oksigjenit tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një nivel të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Llambas Kosova” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 10.03$). Edhe pse ekziston dallim i theksuar në mes rezultateve minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Tabela 2. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe funksionale të futbollistëve të KF “Llambas Kosova”

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis	KV
ALARTË	20	1727.00	1890.00	1805.7000	47.32875	.217	-.722	2.621075
APESHA	20	64.00	95.00	75.0500	7.62596	1.220	1.697	10.16117
AIDHNB	20	6.20	19.80	10.5400	4.39143	.998	-.273	41.66442
BMI	20	19.87	28.03	23.0029	1.93760	.427	1.239	8.423286
MATAKT	20	58.35	78.66	65.8776	5.12699	1.109	1.018	7.7826
MATPAS	20	5.65	16.34	9.1724	2.91014	1.052	.619	31.72714
VO2MAX	20	42.40	61.00	50.9450	5.11268	.016	-.548	10.03569

Në tabelën 3 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe funksionale te futbollistët e KF “Drenica”. Mostra ka përfshirë grupin 20 futbollist të të moshës mbi 19 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike lartësia e trupit (ALARTË) (Tabela 2) është 178.29cm. Rezultati minimal (168.00cm) dhe ai maksimal (188.50cm) i ndryshorës antropometrike lartësia e trupit tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një asim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitive (epikurtike). Futbollistët e KF “Drenica” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 3.39$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik .

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike pesha e trupit (APESHA) është 74.51kg. Rezultati minimal (63.50kg) dhe ai maksimal (91.00kg) i ndryshorës antropometrike pesha e trupit tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një asim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të lartë, sepse testi i asimetrisë është pozitive (epikurtike). Futbollistët e KF “Drenica” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 10.90$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtike

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës antropometrike indi dhjamor nënlëkuror i barkut (AIDHNB) është 9.92mm. Rezultati minimal (5.40mm) dhe ai maksimal (22.00mm) i ndryshorës antropometrike indi dhjamor nënlëkuror i barkut tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrik, si dhe një asim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Drenica” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike nuk paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 45.89$). Ekzistimi i

dallimimeve të theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është platokurtike.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës indeksi i masës trupore (BMI) është 23.40. Rezultati minimal (19.79) dhe ai maksimal (26.88) i ndryshorës të indeksit të masës trupore tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Futbollistët e KF “Drenica” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 7.42$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtik

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës masa aktive trupore (MATAKT) është 65.67kg. Rezultati minimal (56.98kg) dhe ai maksimal (74.91kg) i ndryshorës të masës aktive trupore tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Drenica” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 8.26$). Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është mezokurtike.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës masa pasive trupore (MATPAS) është 8.83kg. Rezultati minimal (5.10kg) dhe ai maksimal (16.69kg) i ndryshorës të masës pasive trupore tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët e KF “Drenica” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike nuk paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($Kv = 34.90$). Ekzistimi i dallimimeve të theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është platokurtike

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës pranimi maksimal i oksigjenit (VO2MAX) është 50.06 ml/kg/min. Rezultati minimal (34.00 ml/kg/min) dhe ai maksimal (58.00 ml/kg/min) i ndryshorës të pranimi maksimal i oksigjenit tregon se egziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshorës ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Futbollistët e KF “Drenica” në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen çka vërtetohet me anë të koeficientit të variacionit ($K_v = 13.12$). Ekzistimi i dallimeve të theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar, distribucioni është platokurtike

Tabela 3. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe funksionale te futbollistët e KF “Drenica”

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis	KV
ALARTË	20	168.00	188.50	178.29	60.50481	.171	-1.074	3.393618
APESHA	20	63.50	91.00	74.5100	8.12416	.706	-.095	10.90345
AIDHNB	20	5.40	22.00	9.9200	4.55257	1.401	1.429	45.89284
BMI	20	19.79	26.88	23.4004	1.73855	-.250	.230	7.429574
MATAKT	20	56.98	74.91	65.6775	5.42930	.275	-.842	8.266606
MATPAS	20	5.10	16.69	8.8325	3.08329	1.292	1.505	34.90846
VO2MAX	20	34.00	58.00	50.0650	6.56949	-1.044	.779	13.12192

Në tabelën 4 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe funksionale te futbollistët e KF “Besa”. Mostra ka përfshirë grupin 20 futbollist të të moshës mbi 19 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

